




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 12.01.2026 DERI MË 16.01.2026

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për përfundimin e marrdhënies së punës.	NRP-02-6898-2026
2.	Vendim për qasje në dokumente publike.	NRP-02-6902-2026
3.	Vendim për caktimin e komisionit disiplinor për nënpunësit e shërbimit publik.	NRP-02-6903-2026
4.	Vendim për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-6906-2026
5.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës. "Furnizimi me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit"	NRP-02-6907-2026
6.	Vendim për Autorizim.	NRP-02-6909-2026
7.	Vendim caktimin e grupit punues për performancë komunale.	NRP-02-6911-2026
8.	Vendim për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanëshme me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit".	NRP-02-6914-2026
9.	Vendim për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.	NRP-02-6915-2026
10.	Vendim për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.	NRP-02-6916-2026
11.	Vendim për dhënie e pushimit nga puna pa pagesë.	NRP-02-6917-2026




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 60, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS

1. **Reshat Shehu** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtar i të hyrave, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS** nga data 4.2.2026.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Buxhet dhe Financa që punëtorin ta largojë nga lista e pagave, nga data 4.2.2026.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Punëtorit **Reshat Shehu** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtar i të hyrave, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS**, nga data 4.2.2026.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, punëtori ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Kopja e vendimit u dorëzohet:

1. Punëtorit,
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
3. Dosjes personale, dhe
4. Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6903 Nr. i faq./Br.str/No.pg 193

Data/Datum/Date 13 / 01 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 85 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për disiplinën e nëpunësve civilë dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit disiplinor për nëpunësit e shërbimit publik

1. **Caktohet** komisioni disiplinor për nëpunësit e shërbimit publik në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Etnik Popaj, kryesues,
 - 1.2. Saranda Rama, anëtare,
 - 1.3. Mirsad Shala, anëtar.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit disiplinor për nëpunësit e shërbimit publik janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për disiplinën e nëpunësve civilë.
3. Mandati i komisionit disiplinor për nëpunësit e shërbimit publik do të jetë 2 (dy) - vjeçar.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/4636 i datës 20.8.2024.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtorisë për Arsim,
- Njesisë së Personelit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-00019118/26, e dt. 13.01.2026 për ndihmë financiare prej 600.00€ (gjashtëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. [redacted] nga Rahoveci me datë 13.01.2026 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 08.01.2026 ka lindur **Vajzë** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për zn [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- **Zn** [redacted] nga Rahoveci,
- **Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtorja për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6307 Nr. i faq/Br.str/No.pg 193
Data/Datum/Date 14 / 01 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Furnizimi me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me numër të kontratës: 623-25-11437-1-2-5/C703, si në vijim:
 - 1.1. Admirim Durguti, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për paga dhe shpenzime në Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Muhamet Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në

Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblërjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblërjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblërjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Menaxheri i kontratës,**
- **Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,**
- **Spektori i Prokurimit, dhe**
- **Arkivi.**


Smaji Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No	6909 Nr. i faq./Br.str/No.pg 193
Data/Datumi/Date	15 / 01 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 30/2024 për procedurën e pranimi të nëpunësve të shërbimit publik në sektorin e shëndetësisë, nenit 74 dhe nenin 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim **AUTORIZOHET** Afrim Oruqi, drejtor e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit, që të ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme për iniciimin e konkursve dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit për pozitat e shërbimit publik në sektorin e shëndetësisë në bashkëpunim me NJMBNJ në Komunën e Rahovecit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik dhe nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr. 30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë është paraparë shpallja e konkursit për pozitat e shërbimit publik në sektorin e shëndetësisë.

Andaj, për shkak të vëllimit të madh të punëve të Zyrtarit Kryesor Administrativ, autorizohet Afrim Oruqi, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit, që të ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme për iniciimin e konkursve dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit për pozitat e shërbimit publik në sektorin e shëndetësisë në bashkëpunim me NJMBNJ në Komunën e Rahovecit.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi u dërgohet:

- Afrim Oruqi, Drejtor i DSHPS-së,
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozotave të Ligjit Nr. 08/L-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 23/2022"), Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2023 për menaxhimin e performancës komunale dhe skemën e grantit për performancë komunale, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e grupit punues për performancë komunale

1. **Caktohet** grupi punues për sistemin e menaxhimit të performancës komunale dhe të skemës së grantit për performancë komunale, në këtë përbërje:
 - 1.1. Bjondina Ramaj – Zyrtare për mbrojtje të mjedisit, koordinatorë;
 - 1.2. Blerta Gashi – Sektori për informim dhe marrëdhënie me publikun, anëtare;
 - 1.3. Ekrem Bytyqi – Sektori për buxhet dhe financa, anëtar;
 - 1.4. Shadat Ukaj – Sektori për kulturë dhe rini, anëtar;
 - 1.5. Shpejtim Mustafa – Sektori për Urbanizëm dhe planifikim hapësinor, anëtar;
 - 1.6. Sylejman Daka – Sektori për shërbime publike, anëtar;
 - 1.7. Skender Hamza – Sektori i kuvendit, anëtar;
 - 1.8. Dritan Sokoli – Sektori i IT-së, anëtar;
 - 1.9. Agron Thaqi – Sektori i personelit, anëtar;
 - 1.10. Saranda Rama – Sektori i shëndetësisë dhe i përkujdesjes sociale, anëtare;
 - 1.11. Fidan Hoti – Sektori për ekonomi, zhvillim dhe turizëm, anëtar;
 - 1.12. Jeton Krasnqi – Sektori për arsim, anëtar;
 - 1.13. Alban Gashi – Sektori për barazi gjinore, anëtar;
 - 1.14. Venhar Topalli – Sektori për shërbime publike, anëtar.
2. Grupi punues, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të merret me sistemin e menaxhimit të performancës komunale dhe të skemës së grantit për performancë komunale në Komunën e Rahovecit.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2023 për menaxhimin e performancës komunale dhe skemën e grantit për performancë komunale.

4. Grupi punues do të bëjë mbledhjen, pranimin, verifikimin dhe publikimin e të dhënave të siguruara nga drejtoritë dhe sektorët përkatës sipas indikatorëve të caktuar në Ligjin Nr. 08/L-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 01/2023 për menaxhimin e performancës komunale dhe skemën e grantit për performancë komunale.
5. Obligohet koordinatorja e grupit punues që, në baza periodike, t'i raportojë me shkrim kryetarit të Komunës për punën e grupit punues.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e grupit punues dhe drejtoritë përkatëse në Komunën e Rahovecit.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/3798 i datës 1.2.2024.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të grupit punues,*
- *Drejtorëve të drejtorive,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



RIKUTUBIJA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6914 Nr. i faq./Br.str/No.pg 104

Data/Datum/Date 16.01.26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kërkesës dhe rekomandimit të Menaxherit të Projektit me Nr. Prot. 265 të datës 12.01.2026 për ndërprerjen e kontratës me titull: “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit” me nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C622, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C622 dhe me nr. prot. 3053, e datës 24.9.2024.
2. **Obligohet** Zyra e Prokurimit që t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Dafina Gashi nga fshati Nagac, komuna e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë të menaxheri i kontratës me nr. prot 4168, të datës 22.12.2025, për shkëputjen e kontratës me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C622 dhe me nr. prot. 3053, e datës 24.9.2024, e cila ishte e angazhuar si konsulente individuale për vlerësimin dhe mirëmbajtjen e monumenteve kulturore.

Pas kësaj, menaxheri i kontratës, me kërkesën me nr. prot. 265, të datës 12.1.2026, ka kërkuar dhe njëherit ka rekomanduar Zyrтарin Kryesor Administrativ ndërprerjen e kontratës me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C622 dhe me nr. prot. 3053, e datës 24.9.2024, me të cilën Dafina Gashi ishte e angazhuar si konsulente individuale për vlerësimin dhe mirëmbajtjen e monumenteve kulturore.

Duke u bazuar në nenin 10 të Kushtet e Përgjithshme të Kontratës me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C622, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, janë

përmbushur të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kësaj kontrate, me kërkesë të ofruesit të shërbimeve.

Pas administrimit të të gjitha provave, kryetari i Komunës, ka konstatuar që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me nr. prot. 3053, të datës 24.9.2024, me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C622.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim, ka të drejtën e ankesës në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të tij, në Autoritetin Kontraktues.

Me vendim të njoftohen:

- *Dafina Gashi,*
- *Zyra e Prokurimit,*
- *Menaxheri i projektit,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E RAHOVECI/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINETI PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No <u>02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)</u>
Nr./Br./No <u>6315</u> Nr. i faq./Br.str./No.pg <u>194</u>
Data/Datum/Date <u>16 / 01 / 26</u>
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

- Caktohet** komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues, në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fidan Hoti, kryesues;
 - 1.2. Artan Asllani, anëtar;
 - 1.3. Sevdije Dina, anëtare.
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë mbikëqyrjen dhe monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, respektivisht ecurinë e zbatimit të ofertës së prezantuar, ecurinë e zbatimit të planit dinamik, realizimin e kontratës dhe implementimin e arritjen e qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme.
- Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.
- Komisioni do të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në baza periodike, respektivisht çdo 6 (gjashtë) muaj dhe atë më së largu më 15 maj dhe më 15 nëntor të çdo viti.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset drejtori i drejtorisë dhe anëtarët e komisionit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6916 Nr. i faq/Br.str/No.pg 194
Data/Datum/Date 16 / 01 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. **Caktohet** komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas planit dinamik realizues, në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në këtë përbërje:
 - 1.1. Blerim Sokoli, kryesues;
 - 1.2. Kosovare Gashi, anëtare;
 - 1.3. Veton Mustafa, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë mbikëqyrjen dhe monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, respektivisht ecurinë e zbatimit të ofertës së prezantuar, ecurinë e zbatimit të planit dinamik, realizimin e kontratës dhe implementimin e arritjen e qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.
4. Komisioni do të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në baza periodike çdo 6 (gjashtë) muaj, dhe atë më së largu më datë 15 maj dhe më datë 15 nëntor të çdo viti.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset drejtori i drejtorisë dhe anëtarët e komisionit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 6917 Nr. i faq/Br.str/No.pg 194		
Data/Datum/Date 16 / 01 / 26		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023”), nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe kërkesës së Ermira Bajraktarit nga fshati Polluzhë, me nr. prot. 261, të datës 12.1.2026, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e Ermira Bajraktarit nga fshati Polluzhë, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: mësimdhënëse në ShFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasel, nga data 1.2.2026 deri më datë 31.1.2027.
2. Të lartpërmendurës në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Obligohet zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit që ta largojë nga lista e pagës të lartpërmendurën, për periudhën sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit, Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ermira Bajraktari nga fshati Polluzhë, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: mësimdhënëse në ShFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasel, ka parashtruar kërkesën me nr. prot. 261, të datës 12.1.2026, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë nga data 1.2.2026 deri më datë 31.1.2027.

Kërkesën për pushim nga puna pa pagesë, e lartpërmendura, e ka parashtruar për arsye të avancimit profesional, respektivisht të ngritjes së kapaciteteve profesionale.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurës i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publikë, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që zyrtari publik ta shfrytëzojë pushimin pa pagesë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim, ka të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit, në komisionin për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- *Ermira Bajraktari nga fshati Polluzhë,*
- *Drejtorja për Arsim,*
- *Drejtorja për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyrtari/ja për paga,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*

